



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 32 (827730)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 6 Gusht 2021

Operacioni vijoi prej orësh nga toka dhe nga ajri për të vënë nën kontroll flakët



Zjarri në gadishullin e Karaburunit, rreth 500 efektivë të FA në terren

Rreth 500 efektivë të Forcave të Armatosura, 50 mjete, 3 helikopterë, zjarrfikëse e autoambulanca u angazhuan prej orëve të para të mëngjesit të datës 3 gusht 2021, në operacionin për shuarjen e flakëve në gadishullin e Karaburunit. Flakët kanë vijuar të jenë aktive përgjatë natës, duke u kthyer

në rrezik për banorët e fshatit Dukat. Aksioni vijoi prej orësh nga toka dhe nga ajri për të vënë nën kontroll flakët, në mënyrë që ato të mos përparojnë drejt Parkut të Llogarasë. Një tjetër vatër aktive ishte në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau Dejës, ku ka rënë zjarr në një sipërfaqe... >>> faqe 2

Zjarret: Situata nën monitorim, angazhim maksimal i FA në të gjithë territorin e vendit



>>> faqe 2

Emergjencat

Zjarret, Peleshi në Bazën e Pashalimanit: Karaburuni e vetmja vatër serioze, kemi menaxhuar me sukses situatën

“Forcat tona të Armatosura janë në të gjithë territorin që në ditën e parë, kur ka filluar kjo stinë e nxehtë. Kushtet atmosferike janë të paparashikueshme, sidomos në një zonë si Gadishulli i Karaburunit” >>> faqe 3



Zv/ministrja e Mbrojtjes në Ksamil

“Para përgjegjësisë penale të gjithë ata që dëmtojnë natyrën”

Efektivët e Forcave të Armatosura dhe të gjithë strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes janë angazhuar këto ditë përkrah pushtetit vendor për shuarjen e vatrave të zjarreve në zona të ndryshme të vendit. Pas gati tetë orësh në betejë me flakët, u arrit që të izolohet vatra në kodrat e Ksamilit. Operacioni u ndoq nga zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, në 31 korrik 2021...



>>> faqe 4

Udhëtim ndër vite me Kozma Dushin

Mësuesi i kantos ndan me ne rrugëtimin e tij në muzikë dhe punën 16 vjeçare në QKMBMFA

Kozma Dushi është një personazh mjaftë interesant në fushën e muzikës, prej vitesh nëpërmjet zërit të tij ai i ka dhënë jetë shumë këngëve. Me një karrierë mbi 45 vjeçare ai ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete, festivale apo koncerte. Numëron me dhjetëra çmime në karrierë, por për të vlerësimi më i madh është respekti, që sheh në sytë e njerëzve... >>> faqe 6



Krerët e Shteteve dhe Qeverive të 30 Aleatëve të NATO-s

Ballkani Perëndimor, rajon me rëndësi strategjike për NATO-n

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 9

PILOTËT E FORCËS AJRORE PËRFUNDONJË TRAJNIMIN

Familjarizim i ekuipazheve ajrore shqiptare me Gardën Kombëtare të New Jersey

faqe 5

HISTORI

Lufta Civile dhe Provokacionet e 2 Gushtit 1949 në shtypin shqiptar

faqe 14-15

Operacioni vijoi prej orësh nga toka dhe nga ajri për të vënë nën kontroll flakët

Zjarri në gadishullin e Karaburunit, rreth 500 efektivë të FA në terren

Rreth 500 efektivë të Forcave të Armatosura, 50 mjete, 3 helikopterë, zjarrfikëse e autoambulanca u angazhuan prej orëve të para të mëngjesit të datës 3 gusht 2021, në operacionin për shuarjen e flakëve në gadishullin e Karaburunit. Flakët kanë vijuar të jenë aktive përgjatë natës, duke u kthyer në rrezik për banorët e fshatit Dukat. Aksioni vijoi prej orësh nga toka dhe nga ajri për të vënë nën kontroll flakët, në mënyrë që ato të mos përparonin drejt Parkut të Llogarasë.

Një tjetër vatër aktive ishte në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau Dejës, ku ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pemë të ndryshme. Shërbimi vendor i MZSH Vau Dejës shkoi në vendngjarje dhe punoi për shuarjen e flakëve.

Gjithashtu puna vijoi për vënien nën

kontroll të zjarrit të rënë në fshatin Qesorat, të njësisë administrative Lunxhëri në bashkinë e Gjirokastrës, ku bashkë me punonjësit e shërbimit të zjarrfikëses së këtij qarku u bashkuan edhe 20 efektivë të FA. Ndërkohë që puna vazhdoi për fikjen e zjarrit në zonën e Dukatit, trupa të tjerë u transportuan me helikopter në qafën e Sherikut, Karaburun, në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit për të neutralizuar edhe vatrat atje që janë kërcënim për parkun e Llogarasë.



Zjarret: Situata nën monitorim, angazhim maksimal i FA në të gjithë territorin e vendit

Forcat e Armatosura shqiptare këto ditë janë në betejë me zjarrin, i cili ka shpërthyer në disa vatra në zona të ndryshme të vendit. Situata e zjarreve në vend ka vijuar si më poshtë:

05 gusht, ora 09.00

Aktualisht në të gjithë vendin janë 6 vatra aktive; 2 janë shuar tërësisht, ndërsa 1 vatër është izoluar. Zjarri në gadishullin e Karaburunit vijon të jetë aktiv. Vazhdon operacioni sërish sot për shuarjen e vatrave. Zjarri në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau Dejës është izoluar në pjesën më të madhe të tij. Sot ka filluar operacioni për shuarjen e plotë të tij. Vijon zjarri edhe në Fushë - Arrëz. Në ndihmë të punonjësve vendorë ka shkuar edhe mbështetja me efektivë nga Forcat e Armatosura. Në fshatin Lukan, në Dibër flakët momentalisht janë izoluar.

Në fshatrat e njësisë administrative Antigone kanë vijuar të jenë aktive vatrat e zjarrit në fshatrat Arshi Lengo, Asim Zeneli, Krinë. Operacioni po vijon për shuarjen përfundimtare të tyre. Në fshatrat e njësisë administrative Lunxhëri vijojnë të jenë aktive vatrat e zjarrit në fshatrat Qesorat, Dhoksat, Tranoshisht dhe Saraqinisht. Ka vijuar operacioni me të gjitha forcat operationale. Vijon të jetë aktiv zjarri në fshatin Gadurovë - Selishtë, bashkia Mallakastër. Sot kanë filluar operacionin forcat në nivel qarku. Është shuar zjarri në një sipërfaqe me pisha dhe shkurre në Qafë Murrë, bashkia Dibër si dhe në Malin e Shëngjinit, bashkia Lezhë.

04 gusht, ora 23.00

Qarku Vlorë: Vazhdon puna nga forcat operationale për shuarjen e zjarrit në gadishullin e Karaburunit, ku janë angazhuar 319 forca të FA, 31 mjete, 4 autoambulanca, 21 punonjës të zjarrfikëses dhe njësisë së pushtetit vendor, si edhe 3 helikopterë. Në fshatin Delisuf të bashkisë Vlorë, vijon të jetë aktiv zjarri i rënë në sipërfaqe me shkurre dhe pisha. Po punohet për izolimin e flakëve.

Qarku Shkodër: Zjarri në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau Dejës është izoluar në pjesën më të madhe të tij, por kanë mbetur vetëm disa vatra të vogla, të cilat po kontrollohen nga forcat në terren. Në qytetin Fushë - Arrëz, bashkia Fushë - Arrëz, vazhdon zjarri. Në ndihmë të forcave dhe mjeteve të njësisë Fushë - Arrëz dhe Pukë

ka shkuar edhe një helikopter. Operacioni për shuarjen e zjarrit do të vijojë ditën e nesërme.

Një zjarr u raportua rreth orës 22:31, në lagjen Tepe të bashkisë Shkodër. Në vendngjarje kanë shkuar 2 mjete të MZSH Shkodër dhe 6 forca të cilët po punojnë për shuarjen e zjarrit.

Qarku Dibër: Vijon të jetë aktiv zjarri në fshatin Lukan, njësi administrative Selishtë, bashkia Dibër. Zjarri ka përparuar në një pjesë shkëmbore më pak të pyllëzuar. Për shuarjen e zjarrit janë angazhuar forcat zjarrfikëse dhe vullnetarë të zonës. Në Qafë - Murrë, njësi administrative Selishtë, bashkia Dibër, vijon zjarri në sipërfaqe me pisha dhe shkurre.

Qarku Gjirokastrë: Në fshatrat e njësisë administrative Antigone kanë vijuar të jenë aktive vatrat e zjarrit në fshatrat Arshi Lengo, Asim Zeneli, Krinë. Në fshatrat e njësisë administrative Lunxhëri vijojnë të jenë aktive vatrat e zjarrit në fshatrat Qesorat, Dhoksat, Tranoshisht dhe Saraqinisht. Po vijon puna për të mbajtur nën kontroll situatën. Në këto vatra zjarri dhe në Parkun Arkeologjik të Antigonesë është punuar gjatë gjithë ditës edhe me një helikopter për shuarjen e flakëve.

Qarku Fier: Një zjarr ka rënë në një sipërfaqe me shkurre, pisha dhe ullishte në fshatin Gadurovë, njësi administrative Selishtë, në Mallakastër. Për shuarjen e tij janë angazhuar forcat zjarrfikëse, të Bashkisë, të Policisë Bashkiake dhe forca vullnetare. Zjarri vijon të jetë aktiv për shkak të sipërfaqes së madhe të favorizuar nga era dhe terrenin të thyer malor.

Qarku Elbasan: Një tjetër zjarr ka rënë rreth orës 22:30 në fshatin Cerujë, bashkia Elbasan, në një sipërfaqe me shkurre. Për shuarjen e flakëve janë në terren forcat e shërbimit vendor të zjarrfikëses.

04 gusht, ora 19.00

Aktualisht në vendin tonë janë 13 vatra zjarri. Në gadishullin e Karaburunit, pavarësisht punës së palodhur e të pandërprerë të efektivëve të FA dhe shërbimit zjarrfikës ka ende prani vatrash zjarri,



por pa rrezik për banesat.

Prani të zjarreve ka edhe në fshatin Cukal, në Shkodër, gjithashtu pa rrezik për banesat. Në Gjirokastrë, vijon zjarri në vatrat në luginën e Lunxhërisë, por pa rrezik për banesat. FA po punojnë së bashku me ato të pushtetit vendor për shuarjen nga toka. Puna po vijon për shuarjen e flakëve në kodrën e pishave në fshatin "Arshi Lengo", ku veç forcave operationale ndërhyrja vijon nga ajri me helikopter.

Zjarret në Fushë - Arrëz rrezikojnë të kalojnë në zonat e banuara, ndaj në ndihmë të forcave që po vijojnë punën prej orësh është dërguar edhe një helikopter për mbështetje nga ajri. Vatra të tjera zjarri, por pa rrezik për jetët e njerëzve dhe banesave janë në monitorim në bashkinë Tepelenë, pyllin e fshatit Shetaj, në fshatin Manskuri në Durrës. Në fshatin Lukan në Dibër, në bashkinë Mallakastër dhe në fshatin Shelcan në Elbasan.

Në operacionet për shuarjen e flakëve në disa zona të vendit janë angazhuar mbi 500 efektivë të Forcave të Armatosura, të cilët vijojnë pa u lodhur punën nga toka dhe nga ajri.

04 gusht, ora 10.00

Pas një pune të palodhur të efektivëve të FA dhe punonjësve të Bashkisë, Shërbimit Pyjor si dhe Forcave Zjarrfikëse është bërë e mundur shuarja e të gjitha vatrave të zjarrit në Gjirokastrë, por situata po mbahet nën monitorim.

Puna nga forcat operationale po vijon për shuarjen e zjarrit në Gadishullin e Karaburunit. Një pjesë e forcave ndodhen në fshatin Delisuf, ku është riaktivizuar vatra e zjarrit. Gjithashtu po punohet për shuarjen e flakëve edhe nga ajri.

Zjarri në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau i Dejës është izoluar në pjesën më të madhe të tij. Kanë mbetur vetëm disa vatra të vogla, të cilat po kontrollohen nga forcat në terren.

Zjarri në qytetin Fushë - Arrëz, bashkia Fushë - Arrëz, vazhdon me intensitet të ulët. Është izoluar një pjesë e madhe e vatrës dhe po punohet për shuarjen përfundimtare. Zjarri ka përparuar në një pjesë shkëmbore, pak e pyllëzuar në fshatin Lukan, njësi administrative Selishtë, në bashkinë Dibër. Vatra mbetet aktive, por pa probleme për përhapje të mëtejshme. Edhe aty janë angazhuar forca të pushtetit vendor, të cilat po mbajnë situatën nën kontroll. Në fshatin Zogas, në Skrapar, zjarri mbetet aktiv, por pa rrezik për banesat. Situata po ndiqet në vijim.

Në Elbasan, në vendin e quajtur "Gropat e Borës", midis fshatrave Cerujë dhe Gur i Zi, njësi administrative Labinot - Mal, ka rënë zjarr në një sipërfaqe pylli me bimësi të ulët. Situata edhe këtu është në monitorim.

03 gusht, ora 20.00

Në gadishullin e Karaburunit, njësi administrative Orikum, bashkia Vlorë, ka vijuar të jetë aktiv zjarri. Në vendngjarje ndodhen 521 forca ushtarake, dhjetëra nga pushteti vendor si forca zjarrfikëse dhe të emergjencave civile, 50 mjete. Po punohet për fikjen e flakëve edhe nga ajri me helikopterë të FA edhe të kontraktuar. Një vatër zjarri është zhvilluar në Himarë, Livadhë rreth orës 11:00; 15 efektivë të Bashkisë Himarë po e mbajnë nën kontroll situatën. Në qarkun e Shkodrës, zjarri ka rënë në një sipërfaqe me shkurre dhe pemë të ndryshme në fshatin Cukal, njësi administrative Shllak, bashkia Vau Dejës. Forcat

e shërbimit vendor të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) në Vau e Dejës sëbashku me forcat pyjore dhe banorë nga komuniteti po punojnë për shuarjen e vatrës, e cila është problematike, pasi po favorizohet nga erërat. Deri tani janë djegur 10 ha kullotë, ndërsa situata është në monitorim.

Në bashkinë Gjirokastrë zjarri ka marrë përmasa të mëdha, duke rrezikuar fshatin Krinë, Asim Zeneli dhe Arshi Lengo. Është raportuar një humbe jete dhe një e plagosur. Puna në terren vijon me të gjitha kapacitetet e qarkut Gjirokastrë (MZSH Gjirokastrë, Dropull, Tepelenë, Libohovë, Përmet), bashkia Sarandë dhe mjete të FA. Po punojnë Forca Zjarrfikëse, Policia Shtetit, forca të Emergjencave Civile, Forca të Armatosura, Urgjenca Mjekësore me 5 autoambulanca. Po punohet për shuarjen e flakëve edhe nga ajri me helikopterë.

Po ashtu është riaktivizuar vatra në kodrat e fshatit Qesorat, njësi administrative Lunxhëri, bashkia Gjirokastrë. Në vendngjarje kanë shkuar 6 zjarrfikës me 2 mjete dhe situata po ndiqet me seriozitet. Është riaktivizuar vatra e zjarrit në pyllin e fshatit Shetaj, njësi administrative Ishëm të Durrësit. Forcat e Policisë së Shtetit, punëtorë të ndërmarrjeve të bashkisë Durrës dhe dy mjete zjarrfikëse me 6 efektivë po punojnë për të mbajtur nën kontroll flakët. Shërbimi i zjarrfikëses në Kavajë ka njoftuar për një vatër zjarri në fshatin Domen në lagjen Xhelezaj. Në vendngjarje ndodhen mjeti zjarrfikës me efektivë të MZSH Kavajë. Në Tiranë, në rrugën "Dine Hoxha", tek Bregu i Lumit, në Paskuqan ka rënë zjarr në një pikë skrapit. Tre shërbime zjarrfikëse si dhe shërbimet e policisë po merren me normalizimin e flakëve. Nuk ka rrezik për banesat. Në qarkun e Beratit u njoftua se ka rënë zjarr në shkurre në fshatin Zogas, në Skrapar. Në vendngjarje kanë shkuar forcat dhe mjetet e MZSh Skrapar, të cilët kanë bërë izolimin e flakëve.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Flakët kërcënuan edhe Bazën e Pashalimanit

Zjarret, Peleshi në Bazën e Pashalimanit: Karaburuni e vetmja vatër serioze, kemi menaxhuar me sukses situatën

“Forcat tona të Armatosura janë në të gjithë territorin që në ditën e parë, kur ka filluar kjo stinë e nxehtë. Kushtet atmosferike janë të paparashikueshme, sidomos në një zonë si Gadishulli i Karaburunit”

Gadishulli i Karaburunit mbetet e vetmja vatër serioze zjarri në vend. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shoqëruar edhe nga prefekti i Vlorës Flamur Mamaj ishin në Bazën e Pashalimanit, më 2 gusht 2021, ku panë nga afër përpjekjet e forcave zjarrfikëse dhe atyre të FA, të cilët prej ditësh vijojnë punën për vënien nën kontroll të flakëve edhe në zona të tjera të vendit.

“Forcat tona të Armatosura janë në të gjithë territorin që në ditën e parë, kur ka filluar kjo stinë e nxehtë, që është pasuar nga zjarre të shumtë. Natyrisht komandanti i bazës ka bërë një punë shumë të mirë dhe duke qenë se rrezikun e kemi prezent do të vazhdojmë punën me shumë intensitet dhe shpresojmë që ta vendosin nën kontroll dhe të fikim brenda pak orësh, le të themi brenda ditës së sotme, por ky nuk mund të jetë një premtime. Kushtet atmosferike janë të paparashikueshme, sidomos në një zonë si Gadishulli i Karaburunit”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministri Peleshi tha se flakët kërcënuan edhe Bazën e Pashalimanit, por falë punës së jashtëzakonshme të mbi 200 efektivëve të FA dhe punonjësve zjarrfikës të qarkut, kjo bazë e rëndësishme u mbajt jashtë rrezikut. Në të gjithë vendin janë në gatishmëri rreth 1200 efektivë të FA, ndërsa janë kryer mbi 60 fluturime me helikopter për të shuar flakët.

Ministri Peleshi shprehu solidaritetin edhe me autoritetet dhe qytetarët e vendeve si Greqia, Turqia, të cilët po përballen me një situatë të tillë. “Ne e konsiderojmë deri tani të menaxhuar me sukses, së pari nuk kemi pasur humbje jetësh, nuk kemi pasur të lënduar, nuk kemi pasur as banesa. Më afër kërcënimit



të zjarreve kanë qenë banesat në zonën e Ksamilit dhe në një fshat të Përmetit. Por tani ato janë shuar. Kanë punuar respektivisht njëzet e ca efektivë të Forcave të Armatosura në secilën prej këtyre dy vatrave që iu afruan edhe për shkak të erërave banesave”, - tha zoti Peleshi.

Nga ana e tij, prefekti i Vlorës

Flamur Mamaj përgëzoi për punën e palodhur efektivët e FA, ndërsa konsideroi të tejkaluar rrezikun për Parkun e Llogarasë.

Tashmë janë tejkaluar situatat e vështira në dy fshatra të Fierit, si dhe janë shuar flakët në njësinë administrative të Mamurrasit, bashkia Kurbin.



ZJARRET, MBLIDHET KOMITETI I MBROJTJES CIVILE

Peleshi: Serioze situata në Karaburun, shtojmë kapacitetet

Komiteti i Mbrojtjes Civile i mbledhur në orët e vona të natës më 2 gusht 2021, diskutoi për situatën e krijuar ditët e fundit nga zjarret në disa zona të vendit. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e vlerësoi serioze gjendjen në gadishullin e Karaburunit, ku vatra kishte marrë përmasa të rrezikshme, ndihmuar edhe nga era, e cila ndikon në përhapjen e flakëve.

Ministri i Mbrojtjes tha se është menaxhuar me sukses shmangia e prekjës së Bazës së Pashalimanit, ndërsa po punohet për shuarjen e vatrës në malin e Dukatit, për të mos lejuar që flakët të kalojnë në Parkun e Llogarasë. Në një kohë që i gjithë rajoni është përfshirë në një situatë të vështirë për shkak të temperaturave të larta, ministri i Mbrojtjes Peleshi tha se kjo vështirëson edhe ndihmën që Shqipëria mund të marrë nga partnerët e saj. Drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako kërkoi maksimizim të bashkëpunimit ndërinstytucional në këtë situatë. Z. Çako informoi se aktualisht në vend janë 3 vatra zjarri efektive. Ai kërkoi nga Policia që të vendosen para përgjegjësishë personat, një pjesë e të cilëve janë identifikuar si autorë të zjarrvënies. Dy vatra zjarri, një në Vaun e Dejës dhe një në fshatin Palokastër në qarkun e Gjirokastrës janë vënë nën kontroll. Ndërsa janë shuar vatrave në Fier, Ksamil, Mamurras e Përmet. Agjencia e Mbrojtjes Civile



ka kontaktuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile në Bruksel, ndërsa ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se ka patur biseda telefonike me homologët në Kroaci e Kosovë, të

cilët kanë shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në rast se do të jetë e nevojshme, në varësi edhe të situatave të tyre të brendshme. Kontakte janë bërë edhe me qeverinë italiane. Prej ditës së martë “do të

jenë në dispozicion tre helikopterë, të cilët do të ndërhyjnë nga ajri për shuarjen e vatrave të zjarrit, veçanërisht në Karaburun”. Komiteti i Mbrojtjes Civile miratoi autorizimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile e Min-

istrisë së Mbrojtjes për të përdorur kapacitete dhe fonde shtesë, në rast të emergjencës, përtej atyre që kanë në dispozicion, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin me subjekte private apo nga jashtë vendit.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes nga Ksamili:

Para përgjegjësisë penale të gjithë ata që dëmtojnë natyrën

Efektivët e Forcave të Armatosura dhe të gjithë strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes janë angazhuar këto ditë përkrah pushtetit vendor për shuarjen e vatrave të zjarreve në zona të ndryshme të vendit. Pas gati tetë orësh në betejë me flakët, u arrit që të izolohej vatra në kodrat e Ksamilit. Operacioni u ndoq nga zëvendësministrja e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, në 31 korrik 2021, e cila në përfundim inspektoi terrenin dhe përgëzoi efektivët e DMR Gjirkastër dhe forcat zjarrfikëse, për punën e palodhur.

“Një falënderim shkon, jo vetëm për forcat operacionale, efektivët e Ksamilit, por për të gjithë efektivët e Shqipërisë, të cilët janë duke shuar vatra të tjera zjarri. Edhe një herë treguat që me punën dhe përkushtimin tuaj të arrijmë që të mos kemi pasoja”, - u shpreh zëvendësministrja e Mbrojtjes.

Ndërkaq ajo paralajmëroi të gjithë zjarrvënësit që, me qëllim ose jo, dëmtojnë natyrën.

“Unë do të kisha një thirrje për të gjithë banorët e Ksamilit, pushuesit, të gjithë qytetarët që të jenë të kujdesshëm me veprimet e tyre dhe siguroj që kushdo që me veprimet e tij rrezikon të shkatërrojë natyrën e bukur që na ka falur Zoti do të vihet para përgjegjësisë penale. Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura të Shqipërisë, të gjitha strukturat e tjera përgjegjëse do të jenë në krye të detyrës për çdo situatë emergjente, që mund të na paraqitet, duke pasur parasysh se jemi në stinën e verës dhe temperaturat e larta janë në disfavorin tonë”, - theksoi zëvendësmin-



istrja e Mbrojtjes. Agjencia e Mbrojtjes Civile bën me dije se puna për normalizimin e situatës po vijon edhe në Karaburun, ku paraqitet rasti më i vështirë. Grupit të punës për shuarjen e flakëve u janë bashkuar edhe 85 forca të tjera, ndër të cilët 40 janë efektivë të FA. Po ashtu puna po vijon edhe në qarkun Fier, ku po punohet me mjete te tonazhit të rëndë.

Vatra aktive mbeten në fshatin Mazhicë, bashkia Bulqizë, ku zjarri ka djegur sipërfaqe me shkurre dhe ferra, por edhe në fshatin Delvinë, bashkia Përmet. Puna po vijon për normalizimin e situatës edhe në fshatin Shikaj, bashkia Kukës, në fshatin Shetaj, bashkia Durrës, ku janë përfshirë nga flakët një sipërfaqe me shkurre, ullishte dhe pyll pishe.



BMR DHE DMR GJIROKASTËR

Reagim i menjëhershëm në eliminimin e rrezikut për banorët dhe shuarjen e zjarreve në Ksamil e Përmet

Efektivat e DMR Gjirkastër të Batalionit të Mbështetjes Rajonale të KM u angazhuan në orët e vona të natës së 31 korrikut dhe 1 gushtit në dy operacione të shuarjes së zjarrit, përkatësisht në afërsi të Ksamilit dhe në Kutal të Përmetit.

Me 22 forca e katër mjete, ushtarakët e Gjirkastër janë nisur në ndihmë të banorëve të Ksamilit në drejtimin e nënkolonel Gramoz Tolës dhe kanë punuar pa pushim në kushte të terrenit të thyer së bashku me efektivat e zjarrfikësve të qytetit të Sarandës dhe pas 4 orësh ata kanë bërë të mundur shuarjen e vatrave, të cilat rrezikonin një zonë të banuar.

Në zonë ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, e cila falënderoi nga afër ushtarakët e DMR Gjirkastër. “Dua të falënderoj efektivët jo vetëm në zonën e Ksamilit, por në të gjithë Shqipërinë, të cilët janë angazhuar maksimalisht në shuarjen e zjarreve. Edhe një herë po na tregoni sakrificën tuaj sublime në emergjencat e llojeve të ndryshme.” - u shpreh ajo. Edhe në datë 1 gusht, efektivët e



Batalionit të Mbështetjes Rajonale me në krye nënkolonel Idriz Kuca, janë nisur menjëherë në drejtim të Përmetit në zonë e Kutalit për shuarjen me sukses të një zjarri, i cili për pak mund të merrte përmasa katastrofike.

Strukturat e Batalionit të Mbështetjes Rajonale me të gjitha strukturat e saj var-tëse si dhe të gjithë efektivat e KM janë në gatishmëri maksimale për përgjigjen në kohë reale të çfarëdolloj situatë që mund të shfaqet në këto ditë të nxehta



Helikopteri Cougar i Forcës Ajrore operacione për shuarjen e zjarreve mbi Karaburun e Pashaliman

Helikopteri Cougar dhe ekujpazhi i tij me pilotë e teknikë në bord, prej 5 orësh e 5 minuta në datë 1 gusht 2021, kryen operacionin për shuarjen e zjarreve mbi Karaburun dhe Pashaliman.

Gjatë këtij operacioni jo të lehtë, për shkak të terrenit të mbuluar nga tymi dhe flakët, Helikopteri Cougar, me ndërhyrjen nga ajri, ka bërë të mundur neutralizimin, shuarjen e mbajtjen nën kontroll të disa vatrave të zjarrit nëpërmjet hedhjes së ujit me kovën e posaçme “Bambi Bucket”.

Ekujpazhi i pilotëve dhe teknikëve të helikopterit Cougar, të Bazës Ajrore Farkë janë duke punuar me intensitet e përkushtim për të bërë të mundur kryerjen me sukses të këtij operacioni.

Kanë përfunduar më 2 gusht 2021, trajnimin dyjavor të 5 pilotët e Forcës Ajrore për familjarizimin e ekipazheve ajrore shqiptare me ato të Gardës Kombëtare të New Jersey të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky është ndërveprimi i dytë me ekipazhet ajrore që kryejnë fluturime në tokën amerikane me Gardën Kombëtare të New Jersey, me qëllim rritjen e kapacitetit operacional ajror të ekipazheve, standardizimin e procedurave dhe ndërveprimin e ekipazheve ajrore shqiptare me ato të Gardës Kombëtare të New Jersey dhe Ushtrisë Amerikane si dhe ruajtjen e rritjen e aftësive operacionale duke përdorur pajisje të ndryshme speciale të aviacionit.

Trajnime të tilla në kuadër të programeve të bashkëpunimit me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC), janë kryer edhe në vitin 2019.

Bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Aviacionit të New Jersey, të Ushtrisë Amerikane (New Jersey Army Aviation National Guard) do të jetë i vazhdueshëm për helikopterët EC145 si dhe për ekipazhet ajrore që do të fluturojnë me helikopterët Black Hawk duke synuar rritjen e kapaciteteve operacionale të ekipazheve ajrore shqiptare në gjithë spektrin e operacioneve ajrore me helikopter, ditën, natën dhe me instrumente në misione ushtarake dhe në mbështetje të emergjencave civile.



Pilotët e Forcës Ajrore përfundojnë trajnimin

Familjarizim i ekipazheve ajrore shqiptare me Gardën Kombëtare të New Jersey



Bashkëpunim midis FA dhe Gardës Kombëtare të New Jersey

“**P**ilotët shqiptarë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë ndodhen në SHBA si pjesë e një bashkëpunimi të gjatë midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Gardës Kombëtare të New Jersey.” Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë publikoi në rubrikën e saj “Foto e ditës”, disa foto nga takimi që gjeneralbrigade, Lisa J. Hou, ndihmësgjenerale e New Jersey, zhvilloi me pilotët nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, ndërsa mban në dorë një portret të gdhendur me shqiponjën shqiptare dhe heroin kombëtar, Skënderbeun. Ambasada bën të ditur se, pilotët shqiptarë morën pjesë në fluturime për t’u familjarizuar me helikopterët UH-72 Lakota të Gardës Kombëtare të New Jersey, si pjesë e një bashkëpunimi të gjatë midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Gardës Kombëtare të New Jersey.



EOD heq municionet e paplasura në disa qytete të Shqipërisë

Siguron komunitetin në zona urbane e rurale

Gjatë kësaj jave, ekipet EOD të Komandës Mbështetëse kanë realizuar me sukses 4 operacione për heqjen e municioneve të gjetura në zona urbane e rurale në Vlorë, Himarë, Korçë dhe Vorë.

Operacioni i parë u krye në Vlorë, ku pas rikonicionit e vlerësimit të kryer nga ekipi EOD në zonën e quajtur plazhi I vjetër u gjet një shtimje kalibër 75 mm. Më pas operacioni vijoi në bashkinë Himarë, ku u gjet 1 shtimje 75 mm.

Operacioni i tretë u zhvillua nga një ekip tjetër EOD në bashkinë Korçë, ku u gjet 1 predhë mortaje italiane e Luftës së II-të Botërore (LIIB). Ndërsa operacioni i fundit EOD u krye me sukses në bashkinë Vorë, ku dy predha artilerie të kalibrit 125 mm u gjetën pranë zonës së Gërdecit dhe u hoqën.

Të gjitha këto municione pas vlerësimeve u cilësuan si të prekshme e të lëvizshme nga ekipet EOD, të cilët morën të gjitha masat e nevojshme sipas protokollit të sigurisë dhe bënë transportimin e magazinimit e tyre në pikën e grumbullimit të përcaktuara në këto raste në pritje për tu eliminuar.



Udhëtim ndër vite me Kozma Dushin

Mësuesi i kantos ndan me ne rrugëtimin e tij në muzikë dhe punën 16 vjeçare në QKMBMMFA

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Kozma Dushi është një personazh mjaftë interesant në fushën e muzikës, prej vitesh nëpërmjet zërit të tij ai i ka dhënë jetë shumë këngëve. Me një karrierë mbi 45 vjeçare ai ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete, festivale apo koncerte. Numëron me dhjetëra çmime në karrierë, por për të vlerësimi më i madh është respekti, që sheh në sytë e njerëzve sa herë që e përshëndesin. ‘Kjo gjë është dhe triumfi im më i madh’- shprehet ai. Fillimet e tij i pati në vendlindje, në qytetin e Beratit. Artisti përfundoi studimet e shkollës së mesme për zooteknik, pasi kishte një pasion mjaftë të madh për kafshët, por me këmbënguljen e vëllait më vonë vijoi studimet në Institutin e Lartë të Arteve. Përfundoi studimet e larta në vitet 1980-1984, më pas karrierën e tij e shoqëruan një sërë aktivitete artistike në të cilat ai formoi muzikantin që është sot. Prej 2005 ai jep mësim kantoje pranë Qendrës së Kulturës së Ministrisë së Mbrojtjes. Më poshtë do të gjeni më shumë detaje nga intervista e zhvilluar me mësuesin e kantos në QKMBMMFA....

Ju keni mbi 45 vite në skenë, si e kujtoni daljen tuaj të parë, po këngën e parë që keni kënduar. Cila ka qenë ajo?

Në përgjithësi jeta artistike fillon në fëmijëri, unë fillimet e mia i kam pasur në moshën 12 vjeçare 1965-1966. Këngën e kam pasur pasion që në shkollë. Profesori i muzikës në shkollën ‘Thimi Tane’ ishte ai që më zbuloi, profesor Bardhyl Ruzi i cili ishte instrumentist në estradën e Beratit, i binte trombës dhe firzamonikës. Në shkollë kur këndonim në korr dëgjoi zërin tim dhe më thotë se duhet të shkoja në Pallatin e Pioneerëve. Ishte pikërisht mësuesi i muzikës i cili u interesua për mua, ai bisedoi me personat e duhur në Pallatin e Pioneerëve me profesor Asqeri Kadena, një mësues i cili i donte dhe i ndihmonte fëmijët. Kënga ime e parë ka qenë për kalldrëmet e Beratit ishte një periudhë që po rregulloheshin. ‘Çekiçi dhe dalta’ ishte kënga, që kam kënduar në festivalin e fëmijëve me muzikë të Luan Sadushit një kompozitor shumë i mirë. Më vonë në moshën 17 vjeçare kam marrë pjesë në estradën profesioniste të qytetit tim.

Festivali i 15-të i vitit 1976 në Radio Televizionin Shqiptarë është fillimi i rrugëtimin tuaj, sa ndryshoi karriera juaj muzikore prej atij momenti ?

Të këndoje në ato vite në Festivalin e Këngës ishte një ëndërr e çdo artisti, e



çdo këngëtar, ishte aktiviteti më i madh i vitit e shikonte gjithë Shqipëria. Fillonte në datat 25-26-27 dhjetor dhe për pak ditë ishte Viti i Ri kështu që vëmendja ishte maksimale. Për një këngëtar në ato vite të merrte pjesë në Festivalin e Këngës ishte një moment shumë i rëndësishëm fitoje emër dhe merrje një rrugëtim tjetër në jetë, sepse luaje me një orkestër me dy dirigjentë të mëdhenj si Fredinand Deda dhe Eno Koço, ndihesh komodi dhe këngët zgjidheshin nga redaksia. Festivali në ato vite për një këngëtar ishte jeta dhe këngët kishin kompozitor, që uleshin dhe punonin posaçërisht për ty, kënga kompozohet në mënyrë që të përshtatej sa më shumë të ishte në nivelin dhe cilësinë e duhur. Kënga e parë në festival ka qenë nga një kompozitor

nga Fieri Nikollaq Bullo ‘Përshëndetje nga Furrnalta’ e poetit Zaho Ulci nga Saranda. Festivali më tregoi një rrugë tjetër mora një respekt përtej qytetit të Beratit, festivali të jepte emër.

Në gjithë këto vite karrierë



muzikore keni krijuar miqësi nga të cilat më vonë kanë lindur dhe bashkëpunime, ju cilin bashkëpunim do të veçonit?

Kam punuar me kompozitorë shumë të mirë të cilëve u jam shumë mirënjohës, Valentin Veizi ka bërë shumë këngë të bukura për mua, që më kanë shoqëruar në rrugëtimin tim artistik. Kam punuar dhe me Luan Zhegun, Agim Prodanin, Flamur Shehun bashkëpunime me kompozitorë, që kishin një emër shumë të mirë. E veçanta e atyre viteve ishte se

këngët kanë pasur melodi dhe tekst shumë të bukur, sigurisht që ka pasur edhe këngëtar shumë të mirë. Në Festivalin e Këngës nuk mund të këndonte kushdo atje ka pasur një komision i cili ishte mjaftë përzgjedhës. Që të këndoje në Festivalin e Këngës duhet të këndoje me estradën profesioniste të atij qyteti nga vije, nëse ishte i talentuar dhe këndoje shumë mirë atëherë do të merrje pjesë.

Prej disa vitesh ju punoni në QKMBMMFA si mësues kantoje për fëmijët e ushtarakeve, si ka qenë kjo eksperiencë për ju ?

Në Qendrën Kulturorë unë kam filluar në 2005 në ato vite ishte me orkestër dhe ende nuk zhvilloheshin kurset. Fëmijët kanë ardhur më vonë rreth vitit 2008, institucioni ishte i vendosur në rrugën e Elbasanit, tek shtëpia e oficerëve dhe më pas kaluam aty ku jemi sot në garnizonin ‘Skëndërbej’. Të punosh me fëmijët është një kënaqësi shumë e madhe, janë fëmijë të talentuar. Kam punuar me ta me shumë pasion i mësoja të këndonin, i mësoja solfezh, i mësoja sesi mund të trajtonin frymëmarrjen për të kënduar bukur për intonacionin, vokalizat që zërin ta kishin gjithmonë në formë. Kam pasur kolegë të mrekullueshëm si Redon Makashi një kantautor i talentuar, apo Sajmir Braho. Në Qendrën Kulturorë punohet fort dhe me shumë seriozitet. Me fëmijët punohet në kurset e muzikës, sportit dhe pikurës. Është një punë që e kam bërë me shumë pasion. Kurset zhvilloheshin çdo të shtunë dhe të diel punonim gati 2-3 orë në ditë, secili grup është i ndarë me orare.

Ju jeni drejt fundit të kontributit tuaj për mësimin e kantos me fëmijët e ushtarakëve a ka ndonjë moment, i cili ju ka mbetur në memorie dhe do të donit ta ndanit me lexuesit e

gazetës ‘ Ushtria’ ?

Më vjen keq që jam në fund të këtij rrugëtimi, por vjen një moshë kur njeriu duhet të tërhiqet, unë do të mbetem në kontakt me këta fëmijë do ti vizitoj vazhdimisht, pasi e di që do të kem mall për ta kam kaluar kohë shumë të mirë, dhe i dua fort. Kam punuar prej 16 vitesh në atë institucion, ndahem me mall, pasi ata tashmë janë pjesë e imja. Kam momente shumë të bukura që mund të ndaj, çdo koncert, festival që kemi zhvilluar është një kujtim. Kori dhe solistët e grupit ishin shumë

të mirë, fëmijë shumë të pasionuar, me sytë e tyre aq shprehës ata të vështronin dhe prisnim më të mirën prej teje. Orët e mësimit që kam zhvilluar me ta kanë qenë të veçanta plot jetë dhe buzëqeshje. Vetë këndim sjell gëzim.

Si është të realizosh art në një institucion aq hermetik sa është ushtria, a ka qenë e vështirë për ju?

Jo nuk ka qenë e vështirë, sepse vërtetë ishim në një ambient ushtarak, por arti ishte i lirshëm nuk pata asnjëherë pengesa për aq koha sa dhe kryenim zbatimin e rregullave. Jam i lumtur që kam punuar në atë institucion dhe kam dhënë kontributin tim.

Gjatë gjithë kësaj kohe keni dhënë mësim kantoje, nëse do të bënit një krahasim me mësuesin tuaj të parë të muzikës dhe atij që ju jeni sot për këta fëmijë si do të ishte ?

Unë besoj se është e njëjta pamje, i njëjti përkushtim ashtu siç punonte mësuesi im me ne, në Shtëpinë e Pioneerit Asqeri Kadena të cilin në e shikonim me përkushtim dhe admirim mendoj se të njëjtën pamje shohin dhe nxënësit në Qendrën Kulturorë pasi jam përpjekur të bëj të njëjtën punë, të përcjell të njëjtin emocion. Mësuesi im ka qenë një shembull për mua, aty ku është pasioni dhe dëshira në mes gjithçka arrihet. Uroj dhe besoj që do të vazhdohet me të njëjtin përkushtim, kjo është e vetmja rrugë e artit. Shumë shpejtë në Qendrën Kulturorë do të vij dhe një foni për të plotësuar akoma dhe më shumë kushtet. Jeta artistike në qendër do të vazhdojë po ashtu siç ka qenë.

Në gjithë këto vite karrierë ju keni marr vazhdimisht vlerësime, çmime por cili ka qenë ai vlerësim që ju e çmoni më së shumti ?

Vlerësimi më i madh për një muzikant është respekti që njerëzit i falin. Unë kam marr vazhdimisht çmime, kam marr titullin ‘Mjeshtër i madh’ kam kënduar në 36 festivale i kam dhënë shpirtin gjithë pasioni im ka shkuar për muzikën, por asgjë nuk krahasohet me vlerësimet që merr nga njerëzit. Respekti, dashuria që ata tregojnë për mua këto përbëjnë vlerësimet më të rëndësishme dhe ato të cilat kanë vërtetë vlerë.

Mendoni se do të realizoni një projekt së shpejti?

Jam duke menduar të realizoj një recital të bëj një përmbledhje të këngëve të mia ndër vite, të realizoj një promocion me një big band me një orkestër me 22 veta, me një dirigjent të mirë. Mendoj ta realizoj vitin që vjen, pasi do kohën e saj çdo gjë duhet të mblidhen këngët, duhen orkestruar është një punë e madhe përpara që më pret për tu realizuar.



Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatët për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisllacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të




Bashkëpunim në logjistikë, në trajnim, aviacion dhe komunikim

Përfaqësuesit e Programit të Partneritetit Shtetëror (SPP) të SHBA, Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe EUCOM vizituan Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Malit të Zi, ku diskutuan planet për bashkëpunimin e ardhshëm në fushat e logjistikës, trajnimit, aviacionit dhe komunikimit. Ekipet amerikane dhe ekipet e malazeze kanë punuar në projekte për të përmirësuar mjetet e komunikimit dhe pajisjet e sigurisë kibernetike, të cilat institucionet mund t'i përdorin në situata krize. Gjithashtu, fokusi i bashkëpunimit ishte në përmirësimin e trajnimit ushtarak në nivelin e kompanisë, si dhe mbështetjen në nivelin e komandës së batalionit.


“Zhvillimi i ndërveprimit, trajnimit i përbashkët dhe ndarja e përvojave me aleatët na bëjnë më të gatshëm t'u përgjigjemi sfidave dhe të forcojmë aftësitë tona”, thotë informacioni.



Stërvitje taktike dypalëshe me të shtëna luftarake në vargmalin Krivolak

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi gjeneralbrigade Smilutin Gjurovic, së bashku me kolegun e tij nga Republika e Maqedonisë së Veriut, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës, gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski dhe zëvendësministrin e Mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut, Bashkim Hasani, ndoqën realizimin e një stërvitje taktike dypalëshe me të shtëna luftarake në vargmalin Krivolak. Gjuroviç theksoi se stërvitja është një vazhdim i bashkëpunimit të shkëlqyer midis forcave të armatosura të dy vendeve dhe se ai është i kënaqur me njohuritë dhe aftësitë që treguan pjesëmarrësit në stërvitje. Ai theksoi se aleatët dhe vendet anëtare të NATO-s duhet të harmonizojnë vazhdimisht procedurat dhe se aktivitete të tilla janë një model i shkëlqyer për forcimin e ndërveprimit.





Ushtria vepron në koordinim me institucionet e tjera, të cilat po bëjnë përpjekje për të kontrolluar zjarrin dhe për të kufizuar përhapjen e tij të mëtejshme. Dje, më 3 gusht, nga ora 07.05 deri në orën 10.00, një helikopter AS-532 nga formacioni ushtarak 32 040 (Krumovo), me një sistem për shuarjen e zjarrit nga ajri, mori pjesë në shuarjen e zjarrit në pyll duke kryer 13 hedhje uji.



Vazhdon ndihma e ushtarakëve nga Forcat Tokësore në shuarjen e zjarrit mbi fshatin Rozino, Komuna Karlovo

Përfshihet edhe helikopteri

Moduli i shuarjes së zjarrit të Brigadës së 61 -të të Mekanizuar është përfshirë në shuarjen e zjarrit mbi fshatin Rozino, komuna Karlovo edhe më 4 gusht. 28 ushtarakë dhe 4 pajisje të specializuara nga formacioni për kontrollin dhe tejkalimin e pasojave të fatkeqësive të Brigadës së 61-të të Mekanizuar Stryama, nën udhëheqjen e kapitenit Ferdo Ferdinandov, nga ora 05.00 ofrojnë ndihmë shërbimeve të zjarrit në shuarjen e zjarrit. Ushtria vepron në koordinim me institucionet e tjera, të cilat po bëjnë përpjekje për të kontrolluar zjarrin dhe për të kufizuar përhapjen e tij të mëtejshme. Dje, më 3 gusht, nga ora 07.05 deri në orën 10.00, një helikopter AS-532 nga formacioni ushtarak 32 040 (Krumovo), me një sistem për shuarjen e zjarrit nga ajri, mori pjesë në shuarjen e zjarrit në pyll duke kryer 13 hedhje uji.

Po ashtu Moduli i zjarrfikësve i Brigadës së 61-të të Mekanizuar iu bashkua luftës kundër zjarrit mbi fshatin Rozino, komuna Karlovo më 3 gusht. 58 ushtarakë dhe pajisje të specializuara nga formacioni për kontrollin dhe tejkalimin e pasojave të fatkeqësive të Brigadës së 61-të të Mekanizuar Stryama, nën udhëheqjen e majorit Stefan Prodanov, Zëvendës Komandant për Sigurimin e Logjistikës të divizionit të raketave kundërajrore të brigadës, nga ora 06.00 e shërbimeve të zjarrit në shuarjen e zjarrit. Ndërsa katastrofa mbulon terren kryesisht të thyer malor, ndihma e ushtarisë, e cila punon së bashku me zjarrfikësit, zyrtarët pyjorë dhe vullnetarët, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Moduli i shuarjes së zjarrit punon në koordinim me institucionet e tjera, të cilat bëjnë përpjekje për të kontrolluar zjarrin dhe për të kufizuar përhapjen e tij të mëtejshme.

Një helikopter nga Forca Ajrore e 24 -të - Krumovo ende po ndihmon zjarrfikësit. Në orën 07:05 të mëngjesit të datës 3 gusht, helikopteri AS 532 AL Cougar u ngrit përsëri për të vazhduar përfshirjen e tij në shuarjen e zjarrit. Dje shuarja e zjarrit nga ajri zgjati më shumë se 4 orë. U bënë 16 lëshime dhe u hodhën mbi 25 tonë ujë. Diga Murla u përdor për të mbushur kovën bambi me ujë.

Për javën e dytë me radhë, ushtarakët nga Baza e 24 -të Ajrore janë përfshirë në mënyrë aktive në shuarjen e zjarreve pyjorë me helikopter. Ekipazhet punojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe përfundimi me sukses i detyrave për të ndihmuar popullatën dëshmor përgatitjen e tyre të mirë. Po ashtu një helikopter AS 532 AL Cougar nga Forcat Ajrore, me një ekipazh nga Baza Ajrore e Krumovës, është përfshirë në shuarjen e një zjarri të madh pyjor që shpërtheu në 2 gusht. Nga ajri, aktivitetet e shuarjes së zjarrit u kryen në zonën e pyllëzuar me vështirësi në Malet Ballkanike në zonën e fshatit Rozino, Komuna Karlovo, Rrethi Plovdiv. Pajisjet dhe ushtarakët e Forcave Ajrore përfshihen me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme "Siguria nga Zjarri dhe Mbrojtja e Popullsisë" në mbështetje të aksioneve të shuarjes së zjarrit.



Ushtarët ndihmuan në shuarjen e zjarreve në rajonin e Haskovo

20 ushtarakë me pajisje nga formacioni ushtarak 52 740 në Haskovo nga Forcat Tokësore, më 1 gusht 2021, ndihmuan në shuarjen e zjarrit të madh në fshatin Bryagovo, rajoni i Haskovo. Ushtarakët ishin në vendngjarje nga ora 06.50 e mëngjesit deri në fund të ditës dhe ndihmuan shërbimet zjarrfikëse në shuarjen e zjarrit që digej në pyje në zona të vështira për t'u arritur pranë fshatrave Ostar Kamak, Komuna Harmanli dhe Bryagovo, Komuna e Haskovës.

Ushtarakët vepronë me kërkesë të autoriteteve lokale dhe me lejen e shefit të Mbrojtjes dhe Komandës së Forcave Tokësore.



SHKOLLA E LARTË E FORCAVE AJRORE "GEORGI BENKOVSKI"

Diplomohen 43 oficerë të rinj

Ju keni bërë zgjedhjen e duhur. Sigurohuni që investimet e shtetit në mbrojtje të bëhen mjaft potenciale parandaluese dhe mbrojtëse. Në emër të udhëheqjes ushtarake, ju uroj suksese, përpara dhe lart ". Me këto fjalë, shefi i Mbrojtjes admirali Emil Eftimov iu drejtua maturanëve të Shkollës së Lartë të Forcave Ajrore "Georgi Benkovski", të cilët më 30 korrik, morën epuletat e tyre të para të oficerëve. Shefi i Mbrojtjes falënderoi gjithashtu komandën dhe stafin mësues të institucionit të lartë arsimor ushtarak për përpjekjet dhe kujdesin për trajnimin dhe edukimin e së ardhmes së Forcave Ajrore bulgare.

Akti solemn i dhënies së gradës së parë oficer "Toger" për 43 të diplomuar të VVVU "Georgi Benkovski" u zhvillua në Plevën në prani të Presidentit dhe Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Rumen Radev, zëvendësministrit të Mbrojtjes Plamen

Yordanov, ushtarakë të lartë, përfaqësues të autoriteteve lokale dhe shtetërore.

Të diplomuarit do të shpërndahen në formacione të ndryshme ushtarake në vend, Graf Ignatievo, Krumovo, Dolna Mitropolia, Bezmer, Bozhurishte, Balchik, VVVU "G. Benkovski. Shefi i Mbrojtjes u bëri thirrje oficerëve të rinj të ndjekin shembullin e brezave të aviatorëve dhe stafit inxhinierik dhe profesionalizmin, përgjegjësinë dhe patriotizmin e tyre. Ai tha se me blerjen dhe vënien në punë të platformës së re luftarake F-16 Block 70, aftësia e Forcave Ajrore për të kryer detyrat e saj përgjegjëse do të rritet.

"Unë jam krenar që, si ju, jam një maturan i kësaj shkolle të lavdishme, ku për dekada energjia dhe guximi i të rinjve takohen me përvojën dhe njohurinë e mençurisë", tha Presidenti Rumen Radev në fjalën e tij para maturanëve. Ai theksoi se suksesi i lartë i maturanëve është një dëshmi e qartë

për rrugën e qendrës të dijës, kërkimit dhe inovacionit të aviacionit, duke ndërtuar një mjedis që tërheq njerëz të rinj, të aftë dhe të aviacionit. "Epuletat e oficerëve janë para së gjithash një përgjegjësi, sepse sot ju jeni të përkushtuar ndaj misionit të shenjtë të garantimit të sovranitetit ajror dhe sigurisë së Atdheut. Në këtë mision, më besoni, nuk ka vend për iluzion. Ajo është e mbushur me rreziqe, sprova dhe netë të gjata pagjumë. Ju mund të keni sukses në këtë mision nëse punoni në kufirin e aftësive tuaja njerëzore. Sepse nuk ka rrugë të mesme në aviacionin ushtarak," tha Presidenti Radev.

Zëvendësministri i Mbrojtjes Plamen Yordanov u uroi suksese oficerëve të rinj. Ai i dha çmimin fituesit të klasës, si dhe libra me tema historike për studentët e shkëlqyer të specializimeve individuale.

"Të dashur maturanë, marrja e sim-

boleve të oficerit dhe rreshterit dhe diplomat e diplomimit për të cilat ju mezi prisnit dhe jeni të entuziazmuar, është shansi juaj për të realizuar ëndrrat tuaja. Por epuletat e oficerëve janë mbi të gjitha një detyrë. Duke i marrë ato, mbi supet tuaja qëndron përgjegjësia e madhe për të siguruar sigurinë dhe pavarësinë e vendit tonë. Si komandantë të ardhshëm, ju duhet të jeni udhëheqës, të motivoni vartësit tuaj si specialistë shumë të trajnuar, të gatshëm për të marrë pjesë në proceset e modernizimit në Forcat Ajrore. Mos u kënaqni me atë që keni arritur, zgjeroni njohuritë, aftësitë dhe përvojën tuaj, azhurnoni dhe fluturonit lart e më lart.". Me këto fjalë, kreu i Luftës së Dytë Botërore, gjeneral-brigade Julian Radojski, iu drejtua të diplomuarëve. Ai i dhuroi Presidentit Rumen Radev një shpatë, në shenjë mirënjohjeje për përpjekjet e kreut të shtetit për të restauruar Shkollën e Lartë të Forcave Ajrore.

Lufta Civile dhe Provokacionet e 2 Gushtit 1949 në shtypin shqiptar



DR. ASLLAN ZEMANI
Përgjegjës i Muzeut i FA-së

(vijon nga numri i kaluar)

Në gjysmën e parë të Shekullit XX trevat shqiptare sikurse ato ballkanike, u përfshinë në një fushë rivaliteti, influencash e interesash politike e ushtarake por sidomos në fundin e viteve '40 (1946-1949), Ballkani u përfshi në një situatë të ndërlikuar ndërkombëtare, ku shtetet perëndimore dhe ato lindore përplaseshin për të siguruar atë që quhej influencë, në vendet e këtij rajoni, me rëndësi të madhe strategjike. Pas Luftës së Dytë Botërore, këto vendeu orjentuan në kahje të ndryshme politike: Jugosllavia, kishte filluar jetën e saj sipas doktrinës sovjetike, por shumë shpejtë, vetëm brenda 5 viteve, ajo pati një anim drejtë Perëndimit demokratik; nga ana tjetër, Greqia, përpigje me çdo kusht, me të gjitha forcat e saj, por edhe me nxitjen, mbështetjen dhe ndihmën në forca ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar si dhe atë financiare, të Shteteve të Bashkuara (përmes Doktrinës Truman dhe Plani Marshall), që të mos binte në kthetrat e tutelën sovjetike, e cila me brutalitetin e vet politik e ushtarak, përbënte rrezik tepër serioz...

Shtypi shqiptar për provokacionet greke

Provokacionet e shumta dhe agresioni monarko-fashist grek me objektiva të reduktuar kundër vendit tonë gjetën një pasqyrim të shumëllojshëm në periodikun shqiptar por edhe në median shqiptare e ndërkohë vihet re se edhe mediat e huaja por edhe ato fqinjëve tanë ballkanik u përfshinë në këtë hulli.

Në kuadrin e "rëndësisë së madhe etnike dhe strategjike" të Epirit të Veriut për Greqinë, sipas Caldarisit, Gazeta "Elinikon Melon" e 30 korrikut, botoi një hartë me pretendimet greke për gjysmën e Shqipërisë, duke njoftuar, se grekët që janë këtu, duhen "çliruar dhe bashkuar me tokën mëmë, bashkë me territorin ku ata jetojnë". Ndërsa edhe gazeta jugosllave "Gilas", njoftonte më 31 gusht të dhëna mbi librin e kundëradmiralit grek Perikles Argiropulos "Pretendimet e Greqisë", në të cilin shtjellohej një plan i ndarjes së Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë. Të dy këta artikuj u bënë pararendës të fillimit të agresionit të 2 Gushtit 1949 nga monarko-fashistët grekë. Më 29-30 janar të vitit 1949 u mbodh Plenumi V i KQ të PKG, i cili analizoi situatën.

Problemet dhe mangësitë që dolën nga konkluzionet të analizuar në Plenumin V i KQ të PKG, më 29-30 janar të vitit 1949, gjetën një pasqyrim të gjerë në shtypin shqiptar nëpërmjet artikujve tematikë mbi krahun ushtarak të PKG, si ai për përballimin me "guxim të ekspeditave të armikut" ndonëse "nuk u arrit të realizohet qëllimi kryesor strategjik" si dhe sigurimi i rezervave njerëzore e materiale nga Ushtria Demokratike Greke (UDG). Shtypi shqiptar vijoi që të botonte artikuj të tjerë me tematikë mbi forcat monarko-fashiste që megjithë ndihmën amerikane, epërsin dhe armatimin modern nuk ia arritën qëllimit



për asgjësimin e Ushtrisë Demokratike gjatë vitit 1948. Në disa raste paraqitet si shumë e rëndësishme përshkrimi në detaje të të gjitha deklaratave dhe fitoreve të Ushtrisë Demokratike Greqisë, kundër asaj kombëtare. Disa suksese të mëdha u deklaruan nga UDG, jo vetëm në rritjen e resurseve njerëzore të saj, në rreth 20 000 luftëtarë por tashmë edhe në rritjen e fuqisë sulmuese, ishin tematikat e tërësisë të artikujve që botohej në periodikun shqiptar të asaj kohe. Një pjesë e artikujve të tjerë të shtypit tonë bënin të ditur vlerësime të natyrave të tjera për Ushtrinë Demokratike Greke, për vendosin paqes si dhe për vrasjen e grekëve të pafajshëm apo dhe se lufta e tyre ishte për pavarësi duke treguar se jo vetëm ishte i kontrolluar rreptësisht nga politika e kohës por edhe jo i vërtetë me lexuesit e vetë.

Sidoqoftë, shtypi i kohës ndër të tjera, u përpoq që nëpërmjet shkrimeve me tematikë nga këto ngjarje, t'i ndërkombëtarizonte e duke i bërë të njohura ngjarjet që po ndodhnin në kufirin tonë jugor. Ajo botoi mjaft artikuj në lidhje me një mbështetje të caktuar që u dha grupeve të ndryshme nëpër botë deri tek strukturat e organizuara të krahut komunist grek, Ushtria Demokratike Greke. Artikuj të tillë ishin shkruar nga grupe studentësh në Londër, të cilët protestuan edhe përpara Ambasadës Greke atje e deri në Këshillin Amerikan të Luftës Greke, i cili i dërgoi Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) një peticion, për të ndaluar furnizimin me armë të Ushtrisë Kombëtare Greke. Artikuj të tillë propagandues e mbështetës për Ushtrinë Demokratike e popullin grek kishin një ndikim të veçantë për situatën e brendshme të vendit e popullit tonë, i cili e kishte kurorëzuar me sukses luftën e tij antifashiste duke fajsuar për këto ngjarje, mbështetësit kryesor të Luftës Civile në Greqi, SHBA-në dhe Britaninë e Madhe. E gjithë kjo propagandë intensive gati e përditshme e artikuloar me terminologjinë e kohës e mbështetur nga PKSh-ja "Për vendosjen e paqes në Greqi" ndikonte shumë tek masat popullore e aq më shumë tek njerëzit e thjeshtëpër mbështetjen errugës së duhur e të drejtë të kësaj kauze, pasi e gjithë bota po vepronte kështu. Bjellorusia, si pjesë e kampit të demokracive popullore, kërkoi ndërprerjen e sulmeve ndaj komunistëve grekë, një fakt që tregonte, se po thuaj i gjithë Kampi i demokracive popullore ishte me UDG-në.

Në artikujt e peroidikëve të ndry-

shëm të shtypit shqiptar, përcilleshin e komentoheshin sukseset e ndryshme të Ushtrisë Demokratike greke kur ajo ishte në kulmin e aktivitetit të saj kryesisht në gjashtëmujorin e parë të vitit 1948, njëkohësisht u anatantuan si gjithmonë edhe mbështetësit e tyre, SHBA-në (përmes Doktrinës Truman dhe Plani Marshall), që në atë kohe po lëkundej mbështetja nga vetë amerikanët për vijimin e financimit të luftës në Greqi, kundër Ushtrisë Demokratike greke.

Në fillimet e vitit 1949 të dy

Greke, urdhëroi pastrimin dhe ekstradimin e popullsisë rurale greke nga banesat e tyre, fshatrat, të cilat rezultoni që të ishin zona të veprimtarisë të Ushtrisë Demokratike për të izoluar e shpëputur atë nga popullsia vendase.

Në tërësi kjo luftë jo vetëm u mbështet shumë nga shtypi shqiptar por e rëndësishme për kohën ishte dhe shoqërimi me tubime e me mitingjetë shumta, formë populiste e përdorur që shpesh mbaheshin nga grupimet shoqërore në qytete e rrethe të ndryshme,



mbështetësit e Ushtrisë Kombëtare greke, SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar përfundimin sa më të shpejtë të Luftës Civile dhe eliminimin përfundimtar të lëvizjes së armatosur në Greqi, intensifikuan më shumë mbështetjen e tyre ushtarake, si në ndërtimin e aeroporteve, rrugëve, skelave detare etj, në organizimin e fuqizimin e forcës ushtarake me një efektiv prej rreth 300.000 ushtarësh të përbërë nga roja kombëtare, xhandërmëria, njësitë e vetmbrojtjes, njësitë e mbrojtjes kombëtare etj, të cilat shtriheshin kryesisht në qytetet më të rëndësishme greke, përfshi edhe kryeqytetin grek, Athinën. Krahas këtij intensifikimi domethënës, gjenerali Van Fleet, komandanti i Ushtrisë Kombëtare

duke mbështetur popullin grek. Në këto tubime të organizuara edhe nga gratë apo të rinjtë përshëndeteshin nga drejtues politikë por edhe nga pjesëmarrsit duke kuptuar mbështetjen dhe lidhjen vendin tonë me këtë luftë. Gjithsesi, ndonëse u organizuan shumë të tilla në vendin tonë, ato pothuajse nuk patën ndonjë ndikim në arenën ndërkombëtare, përveçse nxisnin më shumë monarko-fashistët grekë.

Pas prishjes me Jugosllavinë, studimet gjeostrategjike dhe relacionet e shumta të Fuqive Perëndimore e përcaktuan vendin tonë si "pika më e dobët" e Kampit Socialist, por ndërkohë në kushte politike dhe ekonomike mjaft të vështira dhe të rrezikshmërisë së pavarësisë së vendit, ajo ndoshta e vetmje u angazhua

më shumë se çdo vend tjetër i Evropës Lindore, duke e ndihmuar ngushtësisht lëvizjen greke e për pasojë, nëpërmjet territorit të saj lëviznin natën mjetet ushtarake të transportit për furnizimin me armë, municione e ndihma logjistike për këto formacione, të cilët, ngarkoheshin në Portin e Durrësit me ngarkesa të sjella me vaporë apo pas kurimit të ushtarëve të plagosur bëhej kthimi, shoqërimi dhe dërgimi në front i rreth 1500-2000 ushtarëve grekë që kishin kaluar kufirin dhe ndodheshin në territorin shqiptar, në të cilin kishte rezerva të shumta jo vetëm logjistike për edhe armatime të ndryshme, që shpesh u kthyen në akuza kundër vendit tonë për ndihma ndaj Ushtrisë Demokratike Greke.

Në faqet e shtypit periodik shqiptar të kësaj periudhe propagandohej edhe ana humane e majtistëve grekë, ku binte në syartikujt që shoqëroheshin me fakte dhe shembuj të vërtetë, të krimeve dhe padrejtësive që kryheshin kundër popullsisë greke nga Ushtria monarko-fashiste greke, që nënkuptohej qeveria dhe Ushtria Kombëtare e Athinës. Ajo, jo vetëm gjatë veprimeve të ndryshme luftarake shkatërroi e dogji të mbjellat dhe i ktheu tokat bujqësore në shkretëtira si në Karadievi por njëkohësisht ushtroi terror kundër popullsisë vendase duke i detyruar me dhunë privimin e lirisë.

Monarko-fashizmi me terror e me vrasje shpërnguli banorët nga të gjitha zonat ku ishte vendosur pjesa më e madhe dhe më e gjallë e Ushtrisë Demokratike greke jo për të sulmuar, por për t'u mbrojtur duke i lënë partizanët grekë në vetmi në malet e thata.

Në rrjedhën e veprimtarisë shtrënguese, madje asgjësuese, në kulmin e Luftës Civile, Ushtria Kombëtare greke me mbështetjen amerikano-britanike, për përkrahjen politike që i jepnin kësaj lufte për ndalimin e rrezikut të përhapjes së komunizmit, kreu një sërë operacione çfarosjeje kundër proleteriatit dhe elementit revolucionar, pjesës më revolucionare të popullit grek, sindikalistët dhe komunistët, këta të fundit, në përgjithësi,

vazhduan të qëndronin në qytete, ku u “vranë rreth 50 mijë persona, 6500 komunistë dhe demokratë u pushkatuan, pasi u dënuan nga gjykatat ushtarake që propagandohej se ishin në duart e amerikanëve, të cilët urdhëruan vdekjen e komunistëve, 50 mijë antifashistë u burgosën, vetëm në Peloponez, 5000 njerëz dhe u internuan e shumë ndërta, u bënë subjekt i torturave të tmerrshme. Subjekte të këtij terrori në Greqinë fqinje, u bënë për shumë artikuj të shtypit tonë periodik të asaj periudhe për dënimet mizore, trajtimet mesjetare ndaj të burgosurve si dhe në gjykimet e panumurta për të cilat u theksua dhe u dënuan deri diku nga e gjithë bota.

Në këtë luftë tërësore civile mbi shina ushtarake të të dy ushtrive të mbështetura nga kahje të ndryshme politike, në verën e vitit 1948, raporti forcave dhe i mjeteve ishte dërrmues në favor të Ushtrisë Kombëtare greke. Përveç kësaj, i gjithë ky formacion luftarak, tashmë i ritrajnuar dhe përgatitur për luftime malore, me pëlqimin amerikan ai përdori për herë të parë bomba me napalm, të cilat më pas u përdorën më gjerësisht në Luftën e Vietnamit. Vetëm gjatë luftimeve në Gramoz, u përdorën 338 bomba me napalm në territorin e mbrojtur nga Ushtria Demokratike greke. Për pasojë këto luftime u shoqëruan me shkatërrime të mëdha në tokat, ndërtesat dhe njerëzit, të cilat u pasqyruan edhe në shtypin ndërkombëtar.

Përveç kësaj, në shtypin e kohës nëpërmjet artikujve që u botuan në një propagandë e madhe rreth vrasjes së Manolis Gleso, kryeredaktorit të gazetës “Rizospastis”, një gazetë e majtë në Greqi. Ai ishte përfshirë, që nga vitet e para të pushtimit italian, në grupet komuniste, dhe mbahet si një simbol i komunizmit grek. Po kështu, pushkatimi i 38 sindikalistëve për qasi një lajm të madh dhe u bë objekt propagandë i shumë gazetave të shtypit tonë. Ndërkohë pa dritën e botimit edhe letra që i ishte dërguar Stalinit nga të afërmit e një sindikalisti të dënuar, duke kërkuar që të ndërhynte edhe OKB-ja, por ata gjithsesi u ekzekutuan.

Propaganda e shtypit shqiptar të asaj periudhe tre vjeçare të çlirimit të vendit ofronte e rrokte njëkohësisht edhe probleme të natyrave të tjera, të ndikuara edhe nga shtypi evropian, siç ishte dëshmtimi i krijimit të qeverisë së greke si rezultat i mos arritjes së ndarjes së portofolevetë ministrive e shoqëruar me artikuj të tjerë deklarativë që bllokimi i krijimit të qeverisë së re greke bëhej nga amerikanët. Madje, shtypi evropian me artikujt e botuar për luftën civile greke ndikoi për krijimin e opinionëve të ndryshme gjykimimi të vetë popujve evropianë, për rrjedhojë opinionet publike të të dy vendeve mbështetëse por edhe financuese, nëpërmjet Planit Marshall, akuzonin qeveritë përkatëse për masakrat masive që po ndodhnin në Greqi. Në thelb, nëpërmjet botimit të këtyre artikujve propagandistikë udhëzohej për bindje ideologjike e politike se vendi ynë jo vetëm kishte nevojë për një unitet politik të brendshëm, por kjo veçanërisht duhet të bëhejko gjë edhe me revolucionin popullor grek e fqinjit tonë jugor dhe njëkohësisht vihej në dukje e theksohej se sa luftënxitëse ishte politika e imperializmit amerikan, nëse do të bashkëpunojë me të. Në thelb, në këto artikuj, kurrë nuk u shkruajt e të pranohej se mbrohej dhe ndihmohej komunizmi grek madje, do të huazoheshin e botoheshin artikuj nga Radio “Greqia e Lirë, e cila deklaronte se kurrë nuk kishte pasur ndonjë ndihmë nga pala shqiptare, dhe se fitoret u arritën pa ndihmën shqiptare. E ndërkohë, nga Agjencia Telegrafike Shqiptare u deklarua zyrtarisht se ky ishte thjesht shpifje, se çdo element që hynte në vendin tonë neutralizohej dhe dërgohej në zonat e grumbullimit, pas



çarmatosjes së tyre.

Në një artikull tjetër, që u botua në shtypin shqiptar, për mohimin e pjesëmarrjes së çamëve në radhët e Ushtrisë Demokratike greke, konfirmonte zyrtarisht mos pjesëmarrjen e tyre në këto formacione luftarake greke. Megjithatë, dokumentet e deklasifikuara tregojnë të kundërtën. Me gjithë punën e bërë që nga viti 1948 që filloi rekrutimi i çamëve e deri në mars të vitit 1949 u arrit të mobilizoheshin për në rreshtat e UDG vetëm 130 veta.

Në këtë kohë, Shqipëria u akuzua se kishte thyer rregullat e Organizatës së KB, duke rrëzuar një aeroplan të KB, për misionin UNSCOB, që po kalonte afër territorit shqiptar. Sidoqoftë, shteti shqiptar nuk e pranoi këtë duke e quajtur edhe këtë shpifje të ashpër ndaj shtetit shqiptar. Artikulli u botua në të gjitha gazetatat që qarkulluan në vend.

Fundi i vitit 1949 përcaktoi fundin e lëvizjes komuniste greke së bashku me Ushtrinë Demokratike e “pushtetin e mori e djathta konservatore. Greqia mbeti përfundimisht në sferën Perëndimore. Dhe kjo ndodhi për shkak të asaj marrëveshje të përqindjeve mes të mëdhenjëve duke vënë përballë me forcën e armëve, apo me luftën civile faktorët e brendshëm”. Në këtë kohë, pothuaj në tërësi, të gjithë artikujt e botuar në shtypin kryesor shqiptar vihet re që kishte ndryshuar tematika e mëparshme por objekt tyre tani ishte veprimtaria politike e ndryshimit ligjor që ndodhnin nën diktatin e qeverisë greke siç ishin ato që shkruanin për bashkëpunimin ose lirinë e daljen e shumë bashkëpunësorëve fashistë nga burgjet e në të njëjtën kohë, u miratuan disa ligje për të çliruar ministrat kuizlingë, që kishin bashkëpunuar me pushtuesin gjerman dhe ndërkohë u pushkatuan repertorët dhe gazetarët që ishin pro të majtës greke por pati edhe të tjerë që u torturuan. Në tërësi, të gjitha shkrimet e gazetarëve shqiptarë që u botuan morën edhe iniciu nga disa artikujt deri diku të shumtë të shtypit të huaj, të cilat u shihnin politikën zbatuese të Athinës si një kërcënim të vërtetë për popujt e Ballkanit.

Kauza e Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) pati një solidaritet ndërkombëtar kryesisht nga forcat punëtore-popullore, të lëvizjes komuniste të shteteve perëndimore. Shprehje e këtij solidariteti ishte vizita e delegacionit të partisë komuniste franceze zonën e Greqisë së Lirë dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) në vitin 1949, në të cilin përfshihej edhe poeti i madh surrealist Pol Eluard.

Kauza e Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) pati një solidaritet ndërkombëtar kryesisht nga forcat

punëtore-popullore, të lëvizjes komuniste të shteteve perëndimore. Shprehje e këtij solidariteti ishte vizita e delegacionit të partisë komuniste franceze zonën e Greqisë së Lirë dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Demokratike të Greqisë (DSE) në vitin 1949, në të cilin përfshihej edhe poeti i madh surrealist Pol Eluard.

Në shtypin shqiptar, kjo vizitë, u paraqit si një triumf i komunizmit grek, i cili tani u vizitua edhe nga një parti motër nga perëndimi. Për rrjedhojë nëpërmjet rreshtave të artikujve të shumtë të botuar aludohej se Ushtria Demokratike Greke do të kishte mbështetje akoma më të madhe jo vetëm nga partitë komuniste të vendeve lindore, por tashmë nëpërmjet Partisë Komuniste Franceze do të kishte aleat edhe organizata të fuqishme ose parti e lëvizje komuniste nga perëndimi. Komunizmi perëndimor, nëpërmjet misionit të delegacionit të partisë komuniste franceze u përpoq që të ndikonte në arrijtjen e një armëpushimi në këtë luftë të përgjakshme civile dhe pas saj të krijohej një qeveri me pjesëmarrje sa më të gjerë të partive parlamentare, me përjashtim të gjithë partive apo individëve që ishin pro një politike jashtëzakonisht të ashpër.

Kjo ra si një bombë për propagandën shqiptare, e cila dy javë më vonë, në një artikull të dytë, kritikoi ashpër partinë komuniste franceze që ra në revizionizëm. Në fakt, Partia Komuniste Franceze u përpiq që të luante rolin e ndërmjetësit, pa e mbajtur anën e asnjërës nga palët, por gjendja përsëri u përkeqë akoma më tej me shpartallimin e Ushtrisë Demokratike Greke.

Në gjysmën e parë të vitit 1948, Stalini kishte përfunduar së tepërmi pozitën e tij në disa nga vendet me problematike të Europës Lindore, si në Çekosllavaki, Poloni, Gjermani Lindore etj. pa folur për Shqipërinë, e cila thuhet se e kishte përcaktuar qëndrimin e saj pro komunist menjëherë pas lufte. Në këto kushte, pa e pyetur, BRSS-ja futi në lojë Shqipërinë. Shqipëria ishte i vetmi satelit i Moskës, i cili mbeti besnik, në naivitetin e tij, por që ishte i rrethuar nga kundërshtarët e Bashkimit Sovjetik. Në zbatim të synimeve të tyre strategjike ajo synonte që të vendoste kontrollin mbi ngushticën e Otrantos e përmes asaj të Mesdheut. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, BRSS-ja fitonte epërsi të dukshme e të munguar në pellgun mesdhetar.

Ndërkohë propaganda e shtypit shqiptar për politikën e jashtme për problemet korente greke, orjentohej po përsëri nga Bashkimi Sovjetik,

i cili ishte idhulli dhe tabuja e tij, madje dhe kryetikujt kishin tematika apo referime nga shtypi i saj. Për rrjedhojë, ky orjentim politik ndikonte dukshëm padyshim edhe në shtypin e shkruar shqiptar, i cili zgjidhjet apo mendimet direktiva ishin tematika të artikujve të botuara në peroidikët shqiptar. Për rrjedhojë sipas direktivës ruse për zgjidhjen më të mirë për Greqinë ishte puna “legale” dhe parlamentarizmi me zgjidhje të paqes, pra zgjedhje të lira në Greqi dhe kështu revolucioni do të fitohej me rrugën e parlamentarizmit dhe votime me zgjedhje të lira. Një veprim i tillë u krye në Hollandë, Poloni dhe Çekosllavaki, gjatë vitit 1948, ku nën idenë e “zgjedhjeve të lira” u imponua komunizmi në këto vende. Një gjendje e tillë në parim do të thoshte të njëjtin fat edhe për Greqinë. E njëjta gjë ndodhi edhe me ne, kur sipas propagandës shqiptare, Bashkimi Sovjetik ishte mbrojtësi ynë nga Greqia, sidomos gjatë sulmeve në kufi në gusht të vitit 1949. Madje, mori guxim në një artikull sovjetik për të deklaruar se SHBA ishte prapa Greqisë, në përpjekjet e saj për të pushtuar Shqipërinë.

Një hapësirë të madhe të propagandës të përhapur përmes shtypit për ngjarjet në Greqi, u mbulua nga artikujt e shumtë që sulmonin SHBA-në, si shkaktori i asaj situatë. Një akuzë e madhe nëpërmjet shtypit iu bë Presidentit Truman, i cili që nga viti 1948 me mbështetjen e Kongresit Amerikan financoi mbajtjen ushtarake monarkofashiste me fonde të larta monetare. Po kështu, Amerika shihej si udhëheqësi kryesor që qeveriste vendin si dhe detyroi mbretin Pavli të Glitsburg që të kërkonte ndihmë nga amerikanët. Ndërkohë gjatë luftës civile, humbjet ishin të pranishme, por ndihma amerikane në Greqinë monarkiste ishte shumë më e madhe, mbi 300 milion dollarë, të gjitha këto në kuadrin e Planit Marshall, që falë kësaj ndihme, mundi të përballonte këtë krizë në pjesën më e madhe të Greqisë.

Në kohët e sotme, kur po thuhet të gjitha dokumentet janë deklasifikuar dhe studiuesit janë duke u konsultuar me to po hidhet dritë dhe njohjen e ngjarjeve si dhe personazhet që kanë ndikuar në zgjidhjet e kësaj apo asaj forme në periudha të ndryshme të historisë. Për rrjedhojë në këtë kohë mund të konsultohemi me dokumentet dhe të gjejmë një lidhje midis SHBA, Greqisë dhe Shqipërisë. Por cila ishte?

Presidenti Truman, në raportin vjetor përpara Kongresit Amerikan,

për tematikën e ngjarjeve e kësaj periudhe në Greqinë monarkiste, pranoi për vonesën e përfundimit të luftës civile, që mendohej se do të përfundonte në fund të vitit 1948, duke argumentuar se një pjesë e luftëtarëve guerilas, rreth 8 mijë andartë, gati një e treta e asaj që gjendeshin në Bullgari pas operacioneve në Gramoz u shpërndanë dhe u larguan për në Shqipëri. Kjo gjë, shtyu për më tej kohën e likuidimit të tyre. Kjo ishte një arsye më shumë që SHBA-ja lejoi përdorimin e lëndës djegëse, napalmit nga Ushtria Kombëtare greke në zonën e Gramozit, pasoja e përdorimit të tyre, ndihenakoma edhe në ditët e sotme atje. Kjo ishte më shumë një përpjekje për të ndaluar forcat e Ushtrisë Demokratike greke që të mos kalonin kufirin shqiptar, në vend se të hakmerrej ndaj shqiptarëve.

Faktet dhe dokumentet treguan se sa SHBA mbështesin Shqipërinë. SHBA kishte thirrur gjithnjë për një tërheqje të shqiptarëve nga ndihma ndaj komunizmit grek. Në këmbim, ajo kishte premtuar integritimin e Shqipërisë si një anëtar i plotë i KB. Sidoqoftë, kjo nuk ndodhi kurrë. Një hap i madh prapa për vendin tonë dhe një humbje e madhe për shqiptarët, të cilët edhe pa këtë luftë, ishin në një varfëri ekstreme.

Asnjë prej tyre nuk e mbështeti Greqinë, kur kërkoi aneksimin e Vorio Epir. Ajo kishte deklaruar se ne nuk duam të shtojmë vuajtje të shqiptarët, më shumë sesa ato që po shkakton regjimi komunist, ne me sa duket nuk do ta njihim këtë regjim.

Megjithë faktet e dhëna, shtypin dhe ato të dokumentuara, ne mund të kuptojmë diçka shumë të rëndësishme: Shteti Komunist Shqiptar, u distancua shumë nga realiteti kombëtar, shumë më tepër sesa grupimet politike në Greqi. Kjo e bëri Shqipërinë të verbër me problemet e saj të brendshme dhe kështu të bashkohej me ideologjinë komuniste, duke sfiduar pothuajse atë Stalinist. Kjo politikë shkatërroi vendin dhe ishte hapi i parë drejt izolimit të vendit, jo vetëm nga Evropa, por nga i gjithë Ballkani. Shtypi shqiptar, arma më e rëndësishme dhe e rrezikshme, nuk kishte si synim jashtë, por brenda vendit. Shtypi i një vendi të vogël nuk pati një ndikim të madh jashtë, por ai i brendshëm ishte i madh. Shtypi na tregon se që nga kjo luftë, dhe katër dekadat pasuese, vendi ynë, nuk kishte një gardh hekuri që na ndante nga Perëndimi, por një bunker mbi kokën e tij, duke e izoluar atë nga Perëndimi, si dhe nga Lindja.



EMERGJENCAT

Forcat e Armatosura angazhim maksimal në terren në luftë me zjarrin

“Në të gjithë vendin janë aktualisht 13 vatra zjarri. Në pjesën më të madhe të zonave nuk ka rrezik për banesat. Po punohet me mbështetje edhe nga ajri në Fushë-Arrëz, ku paraqitet rrezik për kalimin e flakëve drejt zonave të banuara. Të gjitha forcat operacionale dhe një mjet helikopter po punojnë për të izoluar vatrat në kodrën e pishave në fshatin “Arshi Lengo”. Mirënjohje dhe respekt për punën e palodhur të të gjithë forcave të FA, atyre të shërbimeve zjarrfikëse, por edhe vullnetarëve që na janë bashkuar.”

